

RAPORT I SHKURTËR

Debat për “Fondet publike në kulturë”

23.11.2015, Prishtinë



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura

Rrjeti i organizatave të pavarura të
kulturës të Kosovës

www.forumikulturor.net



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës
www.forumikulturor.net

Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme International Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.

“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian”

RAPORT I SHKURTËR

Debat për “Fondet publike në kulturë”



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



SWEDEN

Më 19 nëntor 2015, Forumi Kulturor ka organizuar një debat publik për temën e financimit të kulturës. Debatu vjen si rezultat i veprimeve të fundit të ndërmarra nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) lidhur me ndarjen e fondeve publike për institucionet e pavarura të kulturës, si dhe me afatet e shtyra të thirrjes për aplikime për projekte të kulturës, gjë që ka krijuar pakënaqësi të mëdha në skenën artistike.

Qëllimi i këtij debati ishte krijimi i një komunikimi përgjegjës mes përfaqësuesve institucionalë dhe komunitetit të artistëve në kërkimin e qartësisimit të vendimeve aktuale të politikave të marra në baza 'ad hoc' nga ana e qeverisë,

gjegjësisht të zvogëlimit të fondeve për shumë ngjarje kulturore kredibile dhe që gëzojnë respekt (festivale), të cilat janë financuar gjatë viteve të kaluara. Po kështu, thirrja për aplikime e shpallur së fundmi për parashtrimin e projekteve me afat të shkurtër të paraparë ka dëshmuar edhe njëherë se MKRS-ja është duke shkelur kushtet ligjore dhe procedurale – duke mos lënë kështu hapësirë për institucionet kredibile që të aplikojnë. Në këtë debat morën pjesë përfaqësuesit e Ministrisë, komunitetit të artistëve, aktivistë të shoqërisë civile dhe mediet.

Panelin e ka moderuar znj. Shqipe Hajredini, ndërsa folës në panel kanë qenë: z. Sami

Piraj – përfaqësues i MKRS-së dhe znj. Besa Luzha – përfaqësuese e skenës artistike në Kosovë.

Të gjeturat dhe pikat kryesore të paraqitura nga folësit janë renditur më poshtë:

Shqipe Hajredini bëri një prezantim të shkurtër të temës dhe kontekstit të ngritur gjatë vitit 2015 lidhur me vendimet e marra nga MKRS-ja për financimin e institucioneve të kulturës:

-Në vitin 2015 MKRS-ja ka nxjerrë disa vendime, të cilat kanë krijuar pakënaqësi në skenën së artistëve të pavarur;

-Institucionet me peshë të njëjtë juridike nuk do të thotë

që domosdo do të funksionojnë njëjtë në praktikë. Ky proces varet nga shumë faktorë, të cilët mund të pengojnë apo të avancojnë funksionalitetin e institucionit. Një nga faktorët më të rëndësishëm në matjen e funksionalitetit të institucionit ka të bëjë me buxhetin dhe financimin. Rrjedhimisht, gjithmonë pritet që pjesëmarrja, si dhe vëmendja e publikut dhe e palëve të interesuara do të përqendrohet te kjo e fundit. Megjithatë, është thelbësore që procesi i ndarjes së buxhetit dhe financimi të bëhet sipas parimeve të transparencës dhe të llogaridhënies. Mekanizmat e duhur të monitorimit dhe të vlerësimit gjithashtu duhet të vihen në funksion në procese të tilla.

-Forumi Kulturor ka

dhënë disa rekomandime të politikave lidhur me financimin e institucioneve të kulturës në raportin e fundit të politikave, të botuar në nëntor me titull “Drejt një politike kulturore në Kosovë”.

Sami Piraj (MKRS) shpjegoi objektivat kryesore të MKRS-së, duke theksuar rëndësinë e ekzistimit të strukturave institucionale përgjegjëse për kulturë, siç janë Filharmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës; Teatri Kombëtar dhe ansambli “Shota”. Departamenti i kulturës në kuadër të Ministrisë është përgjegjës për bashkërendimin e procesit të financimit brenda këtyre strukturave publike institucionale, si dhe për sektorin e pavarur.

-Përqindja më e madhe e

mjeteve për kulturë ndahet për institucione nën vartësinë e MKRS-së, ndërsa pjesa e mbetur e fondeve shkon për ‘*institucionet e tjera*’, që i referohet Organizatave Joqeveritare (OJQ).

-Të gjitha fondet për institucionet joqeveritare kalojnë nëpër një proces të caktuar të aplikimit, të cilin e shpall MKRS-ja, qoftë në fillim të vitit apo kah fundi i vitit. Kjo procedurë ua mundëson të gjitha organizatave që të aplikojnë, duke respektuar afatet e cekura në thirrjen për propozime.

-Gjatë vitit 2015 janë realizuar dy thirrje për propozime, ku afati për këtë të fundit ka përfunduar tash së voni. Buxheti i paraparë është afro 1200000 euro.

-Gjatë vitit 2015 është

shënuar rritje e numrit të aplikuesve në krahasim me vitet paraprake, ku edhe Ministria është e kënaqur me numrin e aplikimeve të pranuara deri më tani.

-Po ashtu, z. Piraj theksoi se ka raporte dhe fatura të pambyllura që janë trashëguar nga vitet e kaluara, duke nënkuptuar se borxhet nga këto linja të raportimit duhet të mbylLEN sa më shpejt që të jetë e mundur. Gjithashtu, ai ftoi sektorin joqeveritar që t'ia parashtrojnë raportet e tyre financiare dhe faturat MKRS-së.

-Politika e Ministrisë ndërliDhet me përkrahjen edhe të aktiviteteve të tjera artistike jashtë skenës së udhëhequr nga 'elita' në Prishtinë.

-Organizatata joqeveritare kanë kërkuar dhe duhet të

vazhdojnë së kërkuari përkrahjen e donatorëve të tjerë jashtë kornizës institucionale.

-Procedura për ndarjen e fondeve si dhe për miratimin e buxhetit e Ministrisë nuk varet nga vendimet e saj, por nga ato të qeverisë, ku afatet e caktuara duhet të respektohen.

Besa Luzha (përfaqësuese e komunitetit të artistëve dhe drejtoreshë e Chopin

Piano Fest) nuk u pajtua me pikëpamjet e paraqitura nga MKRS-ja. Sipas mendimit të saj, në vitin 2015 çdo gjë kishte filluar gabimisht, duke përfshirë edhe kulturën. Sipas znj. Luzha, disa veprime dhe vendime mbështetin argumentin se Ministria është duke keqmenaxhuar kulturën:

-Komuniteti i artistëve

është i pakënaqur me ndarjen e fondeve në vitin 2015 nga MKRS-ja. Ministria ka bërë gabim, dhe kjo e fundit duhet ta pranojë atë;

-Disa fusha kanë nevojë për përmirësime të menjëhershme. Buxheti për vitin 2016 mbetet e njëjtë me atë të vitit 2015;

-Kultura ka nevojë për ndarje më të mëdha buxhetore, ku duhet të përfshihen linja të qarta buxhetore edhe për institucionet e pavarura;

-Rregullorja e miratuar së fundi për subvencionet në fushën e kulturës, të trashëgimisë kulturore, rinisë dhe sportit ka disa pika të paqarta. E para, përkufizimit të institucioneve, organizatave dhe individëve që mund të subvencionohen nga Ministria i mungojnë sqarimet

substanciale. Përkufizimet se çka konsiderohet 'institucion i kulturës dhe çka institucion i trashëgimisë' në kuadër të shprehjes 'institucionet vartëse të Ministrisë' duhet të ndahen qartazi nga kriteri për financim të organizatave të pavarura (joqeveritare). E dyta, në pikën 1.2 të Rregullores ceket se organizatat joqeveritare kanë të drejtë për aplikim, ndërsa në nenin 12 të të njëjtës Rregullore parashihen dy procedurat për aplikim (thirrjet publike dhe konkurset apo thirrjet për aplikime). Kjo shkakton huti në mënyrën e ndarjes së fondeve të përgjithshme në kuadër të këtij procesi, pra në atë se çka është thirrja publike dhe çka konkursi. E treta, cilat kritere vlejné pas vendimit të Ministrisë? Të gjitha këto do të duhej

të ishin sqaruar në Rregullore.

-Nuk ka transparencë për procedura të themelimit të komisioneve dhe të përbërjes së tyre.

Komentet e pjesëmarrësve

Gazetar nga 'Koha Ditore':

Gjatë monitorimit të veprimeve dhe punës së Ministrisë

vërehet se nuk ka kriterë konsekuente të thirrjes për aplikime apo të shpërndarjes së fondeve për projekte të caktuara.

-Theks më i madh duhet të vihet në qasjen e hapur në informata, duke publikuar njoftimet në faqen e internetit të Ministrisë;

-Vendimet për ndarjen/refuzimin e fondeve për projekte të caktuara është dëshmuar se janë kryekëput politike;

Ares Shporta – përfaqësues i

OJQ-së 'Ec ma Ndryshe':

-Vendimi i nxjerrë së fundi nga Ministria lidhur me

thirrjen për aplikime ka qenë skandaloz. Kjo praktikë duhet të ndryshohet në të ardhmen.

-Nuk ka transparencë se kush emërohet në komisione për zgjedhjen e projekteve.

Profesoresha (Lelja):

-Shembuj të praktikave më të mira mund të merren edhe nga vendet e zhvilluara.

-Ngjarjet artistike duhet të dallohen në bazë të cilësisë dhe jo në bazë të sasisë së tyre.

-Duhet të krijohet një sistem ku artisti mund ta avancojë vetveten dhe cilësinë e punës së vet.

Përfaqësues i një OJQ-je në

Prizren:

-Kriteret e njëjta për subvencione dhe propozime të

projekteve duhet të ekzistojnë edhe për institucionet publike.




Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë



Implementuar nga:





forumikulturor.net
facebook.com/ForumiKulturor
twitter.com/forumikulturor